



BULETIN JAVOR

10-14 QERSHOR 2024



PËRMBAJTJA

- AKSK Organizon Takimin Përmbyllës për Metodologjinë e Identifikimit të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit
- Shqipëria është zyrtarisht anëtare e Qendrës Europiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibrive në Helsinki.

AKSK Organizon Takimin Përmbyllës për Metodologjinë e Identifikimit të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) organizoi sot takimin konsultues përmbyllës mbi draft metodologjinë për identifikimin dhe klasifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit.

Ky proces intensiv gjithëpërfshirës i drejtuar nga AKSK, me mbështetjen e ekspertëve nga eGA, Estoni, shënon një hap të rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit me operatorët e infrastrukturave të informacionit të sektorit publik dhe atij privat.

AKSK mbetet i angazhuar për të garantuar pjesëmarrje, transparencë, efikasitet dhe koherencë në proceset e vendimmarrjes për sigurinë kibernetike.

Shqipëria është zyrtarisht anëtare e Qendrës Europiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibrive në Helsinki.

Anëtarësimi kompletton pjesëmarrjen e të gjitha vendeve të BE dhe NATO në këtë organizatë, për të mundësuar kështu një qasje të unifikuar mes aleatësh kundër kërcënimeve hibrive, Dizinformimit dhe Manipulimit të Informacionit nga Shtetet e Huaja.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike u përfaqësua nga Znj. Esmeralda Kazia, Drejtor, Drejtorja e Monitorimit dhe Reagimit ndaj Incidenteve në Qendrën Operacionale SOC C-SIRT në Helsinki.

Së bashku, po ndërtojmë themelet për një të ardhme më të sigurt dhe të qëndrueshme për rajonin euro-atlantik.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039